

Akt Themelimi

I shoqërisë tregtare "LEMETI EXCHANGE" SH.P.K.

Mbeshtetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lire dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit", të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Për Q.K.B dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lire, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, unë themeluesi Z. Shkelzen Lemeti, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "LEMETI EXCHANGE" SH.P.K. me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Sot me date 23/09/2022, formohet shoqëria tregtare private e quajtur "LEMETI EXCHANGE" SH.P.K. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa deget që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë seline dega. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaket themelues.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane Kavaje KAVAJE Rruga nr 03, Zone Kadastrale 8552, Nr Pasurie 4/81-N1/3, Volumi 42, Faqe 143 2501
Objektivi i Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- a) Këmbim Valutor;
- b) Transferim të Parave në emër dhe për llogari të institucionit financiar jo Bankë;
- c) Ushtrimi i veprimtarisë së ndërmjetësit në sigurime si agjent;
- ç) Ushtrim i ndërmjetësit të pagesave utilitare;
- d) Ushtrimin e veprimtarisë së agjentit të shërbimeve telefonike dhe celulare;
- dh) Shoqëria ka të drejtë të kryej shërbimet e transfertave të parave, shërbimin e pagesave, komisionerit dhe shkëmbimit të vlerave monetare (exchange) për llogari të saj apo të çdo subjekti financiar jobankë.
- e) Ushtrimi i veprimtarisë si agjent Postar.
- ë) Organizime paketash turistike dhe pushimesh në grup dhe individuale. Shitje biletash avioni, trageti dhe autobusi, rezervim hotelesh dhe shërbime të tjera në fushën e turizmit brenda dhe jashtë vendit

Kohezgjatja e Shoqërisë

Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shperbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Kapitali i Shoqërisë



Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë (njeqind mije) Lekë.

1. Ortaku themelues Z. Shkelzen Lemeti: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000(Njeqind mije) leke ne para, që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Drejtimi i Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori Z. Shkelzen Lemeti, te cilet do te jene dhe perfaqesuesi ligjore i saj. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe kane kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej Tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posaçme.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve.

Neni 8

Ortaket kane te drejte te emerojne dhe administratore te tjere te vlerave materiale.

Kane te drejte te caktojne financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Kavaje.

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "LEMETI EXCHANGE" SH.P.K.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket.

Ortaku themelues

Z. Shkelzen Lemeti

